



Akti i Themelimit i/
Act of Incorporation of

BKT Pay SH.A.

Shoqëri aksionare me ofertë private/
Joint stock company with private offer



Tiranë më/Tirana on
27 korrik/July 2022

<p style="text-align: center;">AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE</p>	<p style="text-align: center;">ACT OF INCORPORATION OF THE JOINT STOCK COMPANY WITH PRIVATE OFFER</p>
<p>“BKT PAY” SH.A.</p>	
<p>Sot, në Tiranë, më 27 korrik 2022, u miratua ky Akt Themelimi si më poshtë:</p> <p>Shoqëria BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A., shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”) me numër regjistrimi (NUIS) J62001011Q, me seli në Rrugën e Vilave, Lundër 1, Tiranë, Shqipëri (“Aksionari i Vetëm”).</p>	<p>Today, in Tirana, on 27 July 2022 is adopted the present Act of Incorporation, as follows:</p> <p>The company BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A., a joint stock company established under the laws of the Republic of Albania, registered with the Albanian National Business Centre (“NBC”) under registration number (<i>alb.</i> NUIS) J62001011Q, with legal seat at Rruga e Vilave, Lundër 1, Tirana, Albania (“Sole Shareholder”).</p>
<p style="text-align: center;">I. THEMELIMI</p> <p>1.1 Aksionari i Vetëm miraton themelimin e shoqërisë aksionare shqiptare me ofertë private “BKT Pay” SH.A. (këtu e më tej referuar si “Shoqëria”), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i përditësuar (këtu e më tej referuar si “Ligji për Shoqëritë Tregtare”), Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më tej referuar si “Ligji për Bankat”), Ligjit Nr. 55/2020, datë 30.04.2020, “Për shërbimet e pagesave” (këtu e më tej referuar si “Ligji për Shërbimet e Pagesave”), dhe Vendimi Nr. 59, datë 24.11.2021, “Për miratimin e rregullores “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave” (këtu e më tej referuar si “Rregullorja e Licencimit”).</p> <p>1.2 Selia e Shoqërisë është në adresën: Në ambientet e degës Banka Kombëtare Tregtare, Rruga “Ismail Qemali”, kryqëzimi i rrugës Vaso Pasha me rrugën Ismail Qemali, tek ish Blloku, Tiranë, Shqipëri.</p> <p>1.3 Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pakufizuar.</p> <p style="text-align: center;">II. OBJEKTI</p> <p>2.1 Qëllimi i Shoqërisë është të kryejë shërbime pagesash dhe veprimtari të parasë elektronike për një kohëzgjatje të pakufizuar.</p>	<p style="text-align: center;">I. ESTABLISHMENT</p> <p>1.1 The Sole Shareholder hereby approves the establishment of the Albanian joint stock company with private offer “BKT Pay” SH.A. (hereinafter referred to as the “Company”), in accordance with the provisions of the Law No. 9901, dated 14.04.2008 “On entrepreneurs and commercial companies”, as amended (hereinafter referred to as the “Company Law”), the Law No. 9662, dated 18.12.2006 “On banks in the Republic of Albania” (hereinafter referred to as the “Banking Law”), the Law No. 55/2020 dated 30.04.2020 “On payment services” (hereinafter referred to as the “Payment Services Law”), and Decision No. 59, dated 24.11.2021, “On approval of regulation “On the licensing of payment institutions and electronic money institutions and the registration of payment service providers” (hereinafter referred to as the “Licensing Regulation”).</p> <p>1.2 The legal seat of the Company is at: The premises of Banka Kombetare Tregtare Branch, “Ismail Qemali” Street, kryqëzimi i rrugës Vaso Pasha me rrugën Ismail Qemali, tek ish Blloku, Tirana, Albania.</p> <p>1.3 The Company is established for an unlimited duration.</p> <p style="text-align: center;">II. SCOPE OF ACTIVITIES</p> <p>2.1 The purpose of the Company is to conduct payment services and electronic money activities for an unlimited duration.</p>

2.2 Shoqëria, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë dhe kriteret e përcaktuara nga Ligji për Shërbimet e Pagesave, mund të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- (a) Shërbimet e pagesave;
- (b) Transfertat e parave;
- (c) Emetimin e parasë elektronike;
- (d) Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;
- (e) Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;
- (f) Ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
 - (i) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
 - (ii) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
 - (iii) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
- (g) Ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
 - (i) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
 - (ii) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
 - (iii) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat

2.2 The Company, in accordance with the license issued by the Bank of Albania and the criteria defined by the Payment Services Law, may perform the following activities:

- (a) Payment services;
- (b) Money transfer;
- (c) Issuance of electronic money;
- (d) Services enabling cash to be placed on a payment account as well as all the operations required for operating a payment account;
- (e) Services enabling cash withdrawals from a payment account as well as all the operations required for operating a payment account;
- (f) Execution of payment transactions, including transfers of funds on a payment account with the user's payment service provider or with another payment service provider:
 - (i) execution of direct debits, including one-off direct debits;
 - (ii) execution of payment transactions through a payment card or a similar device;
 - (iii) execution of credit transfers, including standing orders.
- (g) Execution of payment transactions where the funds are covered by a credit line for a payment service user:
 - (i) execution of direct debits, including one-off direct debits;
 - (ii) execution of payment transactions through a payment card or a similar device;
 - (iii) execution of credit transfers,

<p>periodike.</p> <p>(h) Emetimin e një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave;</p> <p>(i) Dërgesat e parave;</p> <p>(j) Shërbimin e inicimit të pagesës;</p> <p>(k) Shërbimin e informimit të llogarisë.</p> <p>2.3 Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencën(at) e lëshuara nga Banka e Shqipërisë, për të arritur qëllimet e parashikuara në pikën 2.1 të këtij neni, Shoqëria mund të:</p> <p>(a) kryejë çdo aktivitet tjetër dhe të ofrojë shërbime të tjera financiare, me kusht që një aktivitet i tillë të licencohet dhe lejohet nga autoriteti përkatës;</p> <p>(b) kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për të arritur qëllimin e veprimitarisë së Shoqërisë.</p> <p>2.4 Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përvetëson standardet më të mira etike.</p>	<p>including standing orders.</p> <p>(h) Issuing of payment instruments and/or acquiring of payment transactions;</p> <p>(i) Money remittance;</p> <p>(j) Payment initiation services;</p> <p>(k) Account information services.</p> <p>2.3 In compliance with the Albanian legislation and the license(s) issued to it by the Bank of Albania, in order to achieve the purposes provided in paragraph 2.1 of this article, the Company may:</p> <p>(a) conduct any other activities and offer other financial services, provided that such activity shall be licensed and permitted by the relevant authority;</p> <p>(b) perform any other activity which may be considered useful or necessary in order to achieve the Company's scope of activity.</p> <p>2.4 The Company shall observe all laws and relevant regulations. It embraces best ethical standards.</p>
<p style="text-align: center;">III. STATUTI</p>	<p style="text-align: center;">III. ARTICLES OF ASSOCIATION</p>
<p>Aksionari i Vetëm deklaron miratimin e Statutit të Shoqërisë.</p>	<p>The Sole Shareholder hereby declares the adoption of the Articles of the Association of the Company.</p>
<p style="text-align: center;">IV. KAPITALI</p>	<p style="text-align: center;">IV. SHARE CAPITAL</p>
<p>4.1 Kapitali aksionar i Shoqërisë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht, është 1,000,000 EUR (një milion euro), i ndarë në 100,000 (njëqind mijë) aksione me vlerë nominale 10 EUR (dhjetë euro).</p> <p>4.2 Kapitali aksionar i Shoqërisë është i zotëruar plotësisht nga Aksionari i Vetëm i Shoqërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shoqëria BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A., shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në QKB me numër regjistrimi (NUIS) J62001011Q, me seli të regjistruar në Rrugën e Vilave, 	<p>4.1 The subscribed and fully paid share capital of the Company is 1,000,000 EUR (one million euros), divided into 100,000 (one hundred thousand) shares having a par value of 10 EUR (ten euros).</p> <p>4.2 The share capital of the Company is owned by the Sole Shareholder, as follows:</p> <ul style="list-style-type: none"> • BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A., an Albanian joint stock company established under the laws of the Republic of Albania, registered with the NBC under registration number (<i>alb.</i> NUIS)

Lundër 1, Tiranë, Shqipëri.

J62001011Q, with legal seat at Rruga e Vilave, Lundër 1, Tirana, Albania.

V. KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

V. BOARD OF DIRECTORS

- | | |
|---|---|
| <p>5.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Statutin, ku të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit janë të pavarur (joekzekutivë) dhe të ndryshëm nga Administratori i Shoqërisë.</p> <p>5.2 Afati i emërimit i anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 3 (tre) vjet, me mundësi rizgjedhjeje.</p> <p>5.3 Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit janë emëruar, si më poshtë:</p> <p>(a) Z. Mert Turgut Çalik, shtetas turk, lindur më 10 maj 1994 në Bakirkoy, Turqi, banues në Buyukdere, 34394, Stamboll, Turqi, mbajtës i pasaportës me nr. U11384917; dhe</p> <p>(b) Z. Serdar Sümer, shtetas turk, lindur më 01 janar 1973 në Nevşehir, Turqi, resident in Stamboll, Turqi, mbajtës i pasaportës me nr. U24535310; dhe</p> <p>(c) Z. Ahmet Galip Tozge, shtetas turk, lindur më 24 maj 1967 në Izmir, Turqi, resident in Stamboll, Turqi, mbajtës i pasaportës me nr. U10937884.</p> <p>5.4 Në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë shpërblimin për anëtarët e Këshillit të Administrimit.</p> | <p>5.1 The Board of Directors is composed of 3 (three) members, appointed by the General Assembly resolution in accordance with the Articles of Association, where all of the members of the Board of Directors are independent (non-executive) and different from the General Director of the Company.</p> <p>5.2 The term in office of the members of the Board of Directors is 3 (three) years and they can be reappointed.</p> <p>5.3 The first members of the Board of Directors are appointed, as follows:</p> <p>(a) Mr. Mert Turgut Çalik, Turkish citizen, born on 10 May 1994 in Bakirkoy, Turkey, resident in Buyukdere, 34394, Istanbul, Turkey, identified with passport no. U11384917; and</p> <p>(b) Mr. Serdar Sümer, Turkish citizen, born on 01 January 1973 in Nevşehir, Turkey, resident in Istanbul, Turkey, identified with his passport no. U24535310; and</p> <p>(c) Mr. Ahmet Galip Tozge, Turkish citizen, born on 24 May 1967 in Izmir, Turkey, resident in Istanbul, Turkey, identified with his passport no. U10937884.</p> <p>5.4 In compliance with the Company Law, the General Assembly may establish remuneration for the members of the Board of Directors.</p> |
|---|---|

VI. ADMINISTRATORI

VI. GENERAL DIRECTOR

- | | |
|--|---|
| <p>6.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili është person fizik, i emëruar nga Këshilli i Administrimit.</p> <p>6.2 Administratori emërohet për një mandat 3 (tre) vjet dhe ka të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p>6.3 Administratori i Shoqërisë mund të caktojë një përfaqësues "ab negotia" për kryerjen e</p> | <p>6.1 The Company is administrated by the General Director, who is a physical person, appointed by the Board of Directors.</p> <p>6.2 The General Director is appointed for a 3 (three) years term, and is entitled to re-election.</p> <p>6.2 The General Director of the Company may appoint a representative "ab negotia" for the</p> |
|--|---|

<p>detyrave apo kategorive specifike të detyrave, brenda kufijve të tagrave që i janë dhënë sipas Statutit të Shoqërisë.</p> <p>6.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Znj. Bilgen Aldan, shtetase turke, lindur më 14 janar 1981 në Turqi, banuese në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e pasaportës me nr. U12962516. <p style="text-align: center;">VII. AUDITORËT</p> <p>Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga kontabilistë të autorizuar, të emëruar për një vit fiskal nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Pagesave.</p>	<p>performance of specific duties or categories of duties, within the limits of the powers granted to him according to the Articles of Association of the Company.</p> <p>6.3 The first General Director of the Company is appointed, as follows:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ms. Bilgen Aldan, Turkish citizen, born on 14 January 1981 in Turkey, resident in Tirana, Albania, identified with passport no. U12962516. <p style="text-align: center;">VII. AUDITORS</p> <p>The internal auditing of the Company is performed by certified public accountants, appointed for one fiscal year by the General Assembly, in compliance with the Payment Services Law.</p>
<p><i>Ky Akt i Themelimit është bërë në 4 (katër) kopje origjinale, dygjuhëshe në shqip dhe anglisht. Akti i Themelimit është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare".</i></p>	<p><i>The present Act of Incorporation is made in 4 (four) original, bilingual copies in Albanian and English. The Act of Incorporation is in accordance with the provisions of the Law on Companies.</i></p>

Për dhe në emër të Këshillit Drejtues të:/For and on behalf of the Board of Directors of:

BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.

Z. Mehmet Usta

Z. Serdar Simer

Z. Ahmet Galip Tozge

Z. Mehmet Seyhan Pencabligil

Z. Mert Turgut Çalik